



## **Miratimi i Udhëzimeve të reja për Caktimin e Lëndëve në lëndët penale në Gjykatën Supreme të Kosovës**

Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it me rastin e Asamblesë së 14-të të Gjyqtarëve të EULEX-it e mbajtur në Prizren më 24 mars 2011, dhe e përbërë prej këtyre gjyqtarëve:

Maria Giuliana Civinini, Charles Smith, Ingo Risch, Dariusz Sielicki, Lars Dahlstedt, Gerrit-Marc Sprenger, Tapio Vanamo, Torsten Koschinka, Piero Leanza, Anna Bednarek, Esma Erterzi, Antoinette Lepeltier-Durel, Laura Plesa, Roxana Comsa, Katerina Entcheva, Francesco Florit, Ferdinando Buatier de Mongeot, Karen Asphaug-Warg, Horst Proetel, Johanna Schokkenbroek, Verginiya Micheva-Ruseva, Dragomir Yordanov, Vitor Hugo Pardal, Rositza Buzova, Franciska Fiser, Witold Jakimko, Vladimir Kanev, Hajnalka Karpati, Nikolay Entchev, Christine Lindemann-Proetel, Alexey Ivanov, Tore Thomassen, Mariola Pasnik, Dean Pineles, Anne Kerber, Klaus Huener, Arkadiusz Sedek

*Me 28 vota pro, 1 kundër, asnjë abstenim dhe të 8 gjyqtarëve që nuk e kanë shprehur votën e tyre,*

VENDOS

**Të vërtetohet udhëzimet e reja për caktimin e lëndëve për Gjyqtarët e EULEX-it në lëndët penale në Gjykatën Supreme të Kosovës.**

Maria Giuliana Civinini  
Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

**SHTOJCË: Udhëzime të reja për Caktimin e Lëndëve për Gjyqtarët e EULEX-it në lëndët penale në Gjykatën Supreme të Kosovës**

EULEX Kosovë

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Rruga "Luan Haradinaj"  
Avenya Policore  
Fahu postal: 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
[www.eulex-kosovo.eu](http://www.eulex-kosovo.eu)  
[info@eulex-kosovo.eu](mailto:info@eulex-kosovo.eu)



# Udhëzime për Caktimin e Lëndëve për Gjyqtarët e EULEX-it në Lëndët Penale në Gjykatën Supreme të Kosovës

## *I Baza ligjore*

Caktimi i lëndëve për Gjyqtarët e EULEX-it do të kryhet në përputhje me Ligjin mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053), tash e tutje LmK-ja.

## *II Parimet e sistemit të caktimit të lëndëve*

- **Transparenca**

Caktimi i lëndëve duhet të jetë transparent për palët dhe publikun.

- **Objektiviteti**

Të gjithë duhet ta dinë paraprakisht se ai ose ajo nga cili gjyqtar do të gjykohej (gjyqtarët nuk do të zgjedhin lëndët). Kryetari i kolegjit/gjyqtari raportues duhet të përcaktohet menjëherë pas regjistrimit të lëndës sipas këtyre rregullave.

- **Fleksibiliteti**

Kushtet specifike të punës, numri i vogël i Gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën Supreme dhe rregullat mbi përjashtimin të përcaktuara me KPPPK-në duhet të merren parasysh.

- **Qëndrueshmëria**

Sistemi për caktimin e lëndëve duhet të jetë shembull i zbatimit të duhur të drejtësisë të cilin gjyqtarët vendor mund ta zbatojnë në mënyrë që t'i arrijnë qëllimet e një sistemi të pavarur, transparent dhe efikas gjyqësor.

### **EULEX Kosovë**

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Rruga "Luan Haradinaj"  
Avenjja Policore  
Fahu postal: 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
[www.eulex-kosovo.eu](http://www.eulex-kosovo.eu)  
[info@eulex-kosovo.eu](mailto:info@eulex-kosovo.eu)



- **Ndarja e barabartë e punës së gjyqtarëve**

Ndarja e barabartë e punës së gjyqtarëve është qëllimi i gjykatave. Një mënyrë për të vlerësuar këtë është numri i lëndëve. Edhe pse natyra dhe niveli mund të ndryshoj, numri i lëndëve është një mënyrë për garantimin e ndarjes së barabartë të punës në një periudhë afatgjate.

### **III SISTEMI PËR CAKTIMIN E LËNDËVE**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

Lëndët penale në Gjykatën Supreme të Kosovës do t'i caktohen gjyqtarëve penal të EULEX-it në Gjykatën Supreme si kryetarë të kolegjit në bazë të parimit të ndarjes së barabartë të punës në mes të gjyqtarëve dhe sipas orarit.

E njëjta aplikohet në caktimin e lëndëve për gjyqtarët si anëtarë të kolegjit. Urgjenca e procedurave penale duhet të merret parasysh. Në rastet me urgjencë (siç janë ankesat kundër aktvendimeve) gjyqtarët civil të Gjykatës Supreme mund të veprojnë si kryetarë të kolegjeve dhe në rastet më pak urgjente si anëtarë të kolegjit (në rast se ekziston mungesa e gjyqtarëve të pa përjashtuar të EULEX-it).

Anëtarë të kolegjit preferohet të jenë gjyqtarët vendorë të Gjykatës Supreme të caktuar në lëndët penale. Gjyqtarët vendorë caktohen në kolegje në bazë të orarit i cili përmban emrat e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të caktuar në lëndët penale. Lëndët i caktohen gjyqtarëve vendorë në bazë të ndarjes së barabartë të punës sikurse të gjyqtarët e EULEX-it

(KAGjE-Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it do të veproj vetëm si anëtare e kolegjit në rastet që i përkasin grupit II dhe në lëndët më të gjëra që i përkasin grupit III)

Rregullat e përjashtimit siç janë përcaktuar me KPPPK-në kërkojnë një dallim të mëtutjeshëm në mes të ankesave kundër Aktvendimeve, ankesave kundër Aktgjykimeve, mjeteve të jashtëzakonshme ligjore dhe ankesave tjera.

#### **Grupet e ndryshme në caktimin e lëndëve**

Lëndët ndahen në tri grupe që do të thotë:

##### **I Ankesat kundër aktvendimeve**

#### **EULEX Kosovë**

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Rruga "Luan Haradinaj"  
Avenjja Policore  
Fahu postal: 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
www.eulex-kosovo.eu  
info@eulex-kosovo.eu



**II** Ankesat në shkallën e dytë dhe të tretë kundër aktgjykimeve

**III** Ankesat në mjetet e jashtëzakonshme ligjore dhe të gjitha ankesat tjera ose procedura tjera ligjore

### **Përcjellja e ngarkesës me punë**

Regjistrat/oraret mbahen për detyrat e gjyqtarëve të dyja si kryetarë të kolegjit/gjyqtarë raportues dhe si anëtarë të kolegjit në secilën grup të lartpërmendur (I, II ose III). Orare të ngjashme mbahen gjithashtu lidhur me gjyqtarët vendorë.

Gjyqtarët në orar shfaqen si KAGjE, gjyqtari A, gjyqtari B, gjyqtari C etj. Pas rotacionit të gjyqtarit të Gjykatës Supreme gjyqtari i ri do të zëvendësoj gjyqtarin që shkon bazuar në ngarkesën aktuale të ndërrimit. E njëjta aplikohet edhe te gjyqtarët vendorë.

### **Caktimi i kryetarit të kolegjit/gjyqtarit raportues**

Lëndët do ti caktohen gjyqtarëve në bazë të ndarjes së barabartë të punës (d.m.th.: numrit të lëndëve) ashtu që secili gjyqtar do të ketë numër të barabartë të lëndëve në secilin grup (I, II ose III) si kryetar i kolegjit/gjyqtar raportues dhe si anëtar i kolegjit. Kështu që, lënda pasuese do ti caktohet gjyqtarit që ka numrin më të vogël të lëndëve. Pas arritjes së baraspeshës, lëndët do ti caktohen gjyqtarëve duke filluar me gjyqtarin A. Të njëjtat rregulla aplikohen te gjyqtarët vendorë.

(Në rast se lënda është posaçërisht e ndërlikuar për shkak të materialit gjithëpërfshirës apo të arsyeve tjera, KAGjE-ja mund të vendos pas konsultimit me kryetarin e kolegjit dhe personin kontaktues që kjo lëndë korrespondon me dy apo më tepër lëndë të zakonshme kur caktohen lëndët e reja).

Nëse gjyqtari përjashtohet ose lënda duhet të shqyrtohet me urgjencë, lënda i caktohet gjyqtarit që ka numrin më të vogël të lëndëve. Në rast se gjyqtarët kanë numër të barabartë të lëndëve, lënda duhet ti caktohet gjyqtarëve tjerë duke filluar me Gjyqtarin A. Drejtpeshimi duhet të korrigjohet kur të arrijnë lëndët e reja.

Lënda konsiderohet urgjente nëse paraqitet që gjyqtari me radhë nuk mund të kryej veprimet e nevojshme pa shtyrjen e mungesës së tij/saj në zyre kur kjo mungesë është vendosur dhe aprovuar.

#### **EULEX Kosovë**

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Rruga "Luan Haradinaj"  
Avenyja Policore  
Fahu postal: 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
[www.eulex-kosovo.eu](http://www.eulex-kosovo.eu)  
[info@eulex-kosovo.eu](mailto:info@eulex-kosovo.eu)



## **Caktimi i anëtarëve të kolegjit**

Lëndët do ti caktohen gjyqtarëve si anëtarë të kolegjit në mënyrë të barabartë dhe sipas orarit.

Përbërja e kolegjit duhet të urdhërohet sa më herët që është e mundshme. Anëtarët e kolegjit do të përcaktohen pasi që kryetari i kolegjit/gjyqtari raportues të përgatit lëndën deri në atë nivel që mund të vendoset data provuese për seancën. Kryetari i kolegjit/gjyqtari raportues duhet t'i raportoj personit kontaktues kur lënda është gati për caktimin e datës provuese për seancën.

Personi kontaktues do të zgjedh anëtarin/ët e kolegjit nga mesitë e gjyqtarëve të pa përjashtuar në bazë të orarit.

Pas caktimit të anëtarëve të kolegjit, kryetari i kolegjit/gjyqtari raportues duhet të komunikoj me anëtarët e caktuar të kolegjit të caktuar në lëndët e tij/saj me qëllim të gjetjes së datës provuese për seancën.

## **Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi në fillim të muajit në vazhdim të muajit në të cilin është miratuar/aprovuar nga Asambleja.

Lista aktuale e gjyqtarëve të EULEX-it

### **KAGjE**

Gjyqtari A (Charles Smith)

Gjyqtari B (Gerrit-Marc Sprenger)

Gjyqtari C (Martti Harsia)

Gjyqtari D (Lars Dahlstedt)

### **EULEX Kosovë**

Kryesia e Asamblesë së  
Gjyqtarëve të EULEX-it  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Rruga "Luan Haradinaj"  
Avenjja Policore  
Fahu postal: 268, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
[www.eulex-kosovo.eu](http://www.eulex-kosovo.eu)  
[info@eulex-kosovo.eu](mailto:info@eulex-kosovo.eu)